


Kontrollet e brendshme - 9



- 1. Sigurimi i njohjes së SK**
- 2. Vlerësimi i rreziqeve të gabimeve materiale**
- 3. Të vepruarit sipas vlerësimeve të RrK**
- 4. KB në një mjedis të kompjuterizuar**


Sigurimi i njohjes së KB

KB janë procese që themelohen dhe vihen në funksion nga Bordi i drejtorëve që japin siguri të arsyeshme për arritjen e objektivave të:

- 1) Efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve,
- 2) Besueshmëris së raportimit financiar
- 3) Të vepruarit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi

Kontrollet e brendshme kanë pes elemente:

- 1) Mjedisi i kontrollit
- 2) Procesi i vlerësimit të rrezikut prej entitetit
- 3) Sistemet informative
- 4) Aktivitetet e kontrollit, dhe
- 5) Monitorimi i kontrolleve



Mjedisi i kontrollit

- MK është qëndrimi i përgjithshëm , funksionet, mënyra e sjelljes, ndërgjegjshmëria dhe veprimet e personave përgjegjës për qeverisjen dhe menaxhim, në lidhje me SKB dhe rëndësin që ka për entitetin.
- Është themeli mbi të cilin funksionojnë të gjitha kontrollet.
- Përcaktohet kryesisht prej menaxhmentit të biznesit.
- SNA-të kërkojnë që auditori të siguroj njohuri mbi MK duke mbajtur parasysh:



Mjedisi i kontrollit

- Komunikimi dhe zbatimi detyrimisht i integritetit dhe vlerave etike
- Kujdesi për kompetencën
- Pjesëmarrja e të ngarkuarve me qeverisje
- Filozofia dhe stili i punës së menaxhmentit
- Struktura organizative
- Caktimi i autoritetit dhe përgjegjësive
- Politikat dhe praktikat për burimet njerëzore



Procesi i vlerësimit të Rr. të entitetit

Procesi i vlerësimit të rreziqeve nga ana e auditorit përfshijn:


- Identifikimin e rreziqeve të biznesit që kanë të bëjnë me raportimin financiar
- Vlerëson madhësinë e rreziqeve
- Vlerëson gjasat që rreziqe të tilla të ndodhin me të vërtetë
- Merr vendime për sa i takon veprimeve që të ndërmerren për të menaxhuar rreziqet e biznesit

Sistemet informative

Për të siguruar njohuri mbi SI, auditori duhet patur parasysh:

- Klasat e transaksioneve në veprimtarinë e entitetit të cilat janë të rëndësishme për p.f.
- Procedurat, brenda teknologjive informative dhe sistemeve manuale prej të cilave transak.në fjalë inicoohen, regjistrohen, përpunohen dhe raportohen në p.f.
- Regjistrat përkatës të kontabilitetit, informacionet mbështetëse, dhe llogaritjet specifike në p.f. për inicimin, regj.përp.dhe raportimin
- Mënyrat se si sistemet informative mbledhin ngjarjet dhe kushtet, përveç klasave të trans.të cilat janë të rëndësishme për p.f.
- Procesi i raportimit fin.i cili përdoret për të përgatit p.f.të entitetit, përfshirë çmuarjet në kontabilitet dhe shënimet shpjeguese.

Aktivitetet e kontrollit



Janë politikat dhe procedurat shtesë ndaj mjedisit të kontrollit për të siguruar se entiteti i arrin objektivat e veta specifike.

Aktivitetet specifike të kontrollit janë:

- Miratimi dhe kontrolli i dokumenteve
- Kontrollët mbi aplikimet kompjuterike
- Kontrolli i saktësisë aritmetike të regjistrave
- Mbajtja dhe rishikimi i llog.kontrolluese dhe bilancit vërtetues
- Rakordimet (bërja e vlefshme)
- Krahasimi i rezultateve të numërimit fizik të keshit, letrave me vlerë dhe stoqeve me regjistrat në kontabilitet
- Krahasimi i të dhënave të brendshme me informacionet nga burimet e jashtme
- Kufizimi i qasjes fizike ndaj pasurive dhe regjistrave

Ndarja e detyrave

Dmth. përfshirja e një e më shumë njerëzve në proceset e kontabilitetit. Si rezultat:

- Vështërsim i akteve mashtruese me rastin e regjistrimit në kontabilitet.

Ndarja e detyrave bëhet në mënyra të ndryshme:

- a) Ndarja e funksioneve
 - kryerja e një transaksioni
 - regjistrimi i atij transaksioni
 - mbajtja nën kujdes e pasuris së përfituar nga transaksioni
- b) Hapat përmes të cilave kryhen transaksionet duhet të ndahen
- c) Kryerja e veprimeve të ndryshme në kontabilitet duhet të ndahen. Psh. regjistrimi dhe rakordimi nga i njëjti person.



Monitorimi i kontrolleve

SNA-të kërkojnë që auditori të sigurojë njohjen e llojeve kryesore të aktiviteteve të përdorura nga entiteti për monitorimin e kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar, të cilat përfshirë:

- Aktivitetet e kontrollit që kanë të bëjnë me auditimin,
- Mënyrën se si entiteti inicon veprimet korigjuese ndaj kontrolleve të tij.

Roli i kontrollit i takon kryesisht auditimit të brendshëm. Auditorët mundë të zgjedhin të përdorin punën e auditorëve të brendshëm gjatë kryerjes së punës së tyre.

Kompanit e vogla

- Kontrolli i brendshëm funksionon me përfshirjen e drejtorëve ose pronarëve në menaxhimin e përditshëm.
- Kjo përfshirje mundë t'i ndihmojë ata të anashkalojnë kontrollet.
- Nëse dëshirojnë mundë të përjashtojnë transaksionet nga regjistrat.
- Ndarja e detyrva duket e pa-duhur me numër të vogël të personelit.
- Pronarët kompensojnë për kto mungesa, duke:
 - përshkallëzuar autorizimet, si
 - llogaritjet aritmetike
 - mbikqyrjen

Kompanit e vogla

- Auditorët kanë vështërsi në mungesë të përgjithshme të kontrolleve sepse evidencat në dispozicion për plotësinë e veprimitarisë dhe regjistrave është e pamjaftueshme.
- Megjithatë, një kompani e vogël dhe e menaxhuar mirë duhet të ketë një sistem të kontrolleve të brendshme, dhe të veprojnë në përputhje me ligjin në lidhje me mbajtjen e një sistemi të duhur të kontabilitetit.

Kufizimet në SK dhe KB

Sistemet e kontrolleve të brendshme mundë t'i ofrojnë drejtorëve vetëm siguri të arësyeshme për përmbushjen e objektivave të tyre, për shkak të kufizimeve si:

- Kostot e kontrolleve nuk duhet të jenë më të mëdha se sa përfitimet
- Mundësia e gabimeve njerëzore
- Marëveshjet e fshehta midis punonjëse
- Mundësia e shmangjes të kontrolleve nga menaxhmenti
- KB mundë të jenë të ndërtuara për t'u marrë me transaksionet e zakonshme ose jo të zakonshme

Faktorët kyç të kufizimit janë:

- Gabimet njerëzore
- Mundësia për mashtrime

Vlerësimi i rreziqeve të gabimeve materiale

Auditorët duhet të :

- vlerësojnë përshtatshmërinë e sistemeve të kontabilitetit, si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare
- Identifikojnë rreziqet e gabimeve materiale që mundë të jenë të pranishme në pasqyrat financiare
- Vlerësojnë politikat dhe procedurat të cilat i takojnë pohimet e pasqyrave financiare
- Mbajnë parasysh faktorët të cilët kanë ndikim mbi rrezikun e gabimeve materiale
- Ndërtojnë procedurat e duhura të auditimit.

Regjistrimi i SK dhe atyre të KB

Auditorët duhet të mbajnë regjistra për sistemin e entitetit.

Kjo bëhet nëpërmjet:

- Shënimeve treguese
- Diagrameve për qarkullimin e informacioneve
- Pyetësorëve, dhe
- Listave kontrolluese

Ka dy lloje pyetsorësh me qëllime të ndryshme:

- 1) PKB – përdoren për të gjykuar nëse kontrollet ekzistuese përmbushin objektivat specifike të kontrollit,
- 2) PVKB – përdoren për të përcaktuar nëse ekzistojnë kontrole të cilat parandalojnë ose zbulojnë gabime ose mungesa specifike.

Pyetësorët e KB - PKB

Japin përgjegje në pyetjen - sa të mira janë sistemet e Kontrollleve. PKB-të vlerësojnë sistemet dhe jo përshkrimi i tij.

Nëse zbulohen dobësi, auditorët duhet të pyesin:

- Çfarë gabimeve u japin shteg këto dobësi?
- A janë materiale për pasqyrat financiare ato?
- Cilat procedura të pavarura do të zbulojnë ato gabime?

Pyetsësorët u përmbahen parimeve themelore:

- 1) Përbëhen nga lista e pyetjeve të cilat përcaktojnë nëse janë të pranishme kontrollet e brendshme, dhe
- 2) Formulohen për të mbuluar secilin cikël të rëndësishëm të transaksioneve.

Kontrolli i Faturave të blerjes me fletpranim – pagesa?

PVKB

- Kohët e fundit firmat e auditimit përdorin më shumë vlerësimin e mundësisë së ekzistimit të gabimeve-mashtrimeve specifike se sa ekzistimi i kontrolleve të duhura.
- Këtë e arrijn duke redukuar pyetjet e kontrollit për secilin lloj të transakcionit. Psh.

A ekziston siguria e arsyeshme se:

- *Kërkohet që të bëhet fillimisht marrja në dorëzimin e mallrave ose shërbimeve para se të krijohet një detyrim?*

Secila pyetje kyçe mbështetet prej pikave të detajuara kontrolluese, si:

- *Është e kënaqshme ndarja e detyrave?*
- *A janë të kënaqshme kontrollet mbi skedarët ose dosijet kryesore?*
- *A ekzistojnë regjistra të cilët tregojnë se të gjitha mallrat e marra janë kontrolluar në sasi, cilësi dhe për dëmtime?*

PVKB

- Frazat e pyetjeve në PVKB mundë të ndërtohen ashtu që të theksohen dobësitë të cilat duhet të ishin parandaluar prej një kontrolli përkatës kyç.

Pyetje:

A ka gjasa që mallrat t'i dërgohen blerësve të paautorizuara?

Përgjigje: Nëse “PO”

Kërkohen shpjegime!

PVKB

Kur auditorët besojnë se KB janë të forta, ata i testojnë për të mundë të mbështeten apo jo në to.

Për njohjen e KB zbatojnë testet hap-pas-hapi.psh.një transaksion ndiqet nëpër tërë sistemin për të parë funksionimin e kontrolleve për atë transaksion.

Testet e kontrollit mund të përfshijnë elementet e më poshtme:

- a) Inspektimin e dokumenteve psh.verifikon nëse transaksioni është autorizuar.
- b) Drejtimi i pyetjeve rreth K.B.
- c) Ri-kryerja e procedurave të kontrollit
- d) Ekzaminimi i evidencave mbi pikëpamjet e menaxhmentit
- e) Sistemin e kompjuterizuar
- f) Vëzhgimin e kontrolleve.

PVKB

Auditorët duhet të mbajnë parasysh:

- Mënyrën se si vihen në punë kontrollet
- Njëtrajtshmërinë e vënjes në punë gjatë periudhës
- Prej kujt janë vënë në punë kontrollet në fjalë

Kur auditorët zbulojnë se kontrollet nuk kanë funksionuar aq mirë sa duhet, ata shtojnë procedurat e pavarura.

Dobësitë e mëdha duhet t'i komunikojnë me shkrim përgjegjësve për qeverisje

KB në mjedis të kompjuterizuar

Kontrollet mbi teknologjin informative përfshijnë:

- Kontrollet e përgjithshme, (KP)dhe
- Kontrollet mbi programet (KPr).

KP – të TI kanë për qëllim themelimin e një kornize për kontrollin e përgjithshëm mbi aktivitetet e SIK.

KPr – janë kontrole specifike mbi programet specifike të kontabilitetit të cilat kryhen prej kompjuterëve.

Nga të dyja llojet e kontrolleve qëllimi është të përfitohet siguria e arsyeshme se të gjitha transaksionet janë autorizuar dhe regjistruar, dhe janë përpunuar plotësisht, me saktësi dhe në kohën e duhur.